




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. 2-D/DPK
 Nr. i faq. _____
 Broj stranica 02
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br Prot. 01-526/2013
 Prot No _____
 Data _____
 Datum 20.02.2013
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **04.02.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3062/12, për ztr. *Murat Meha* – Kryshéf i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3062-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. *Murat Meha* – Kryshéf i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, dhe Anëtar i Bordit në Kompaninë Publike “*Ibër-Lepenci*” është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3634/12, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari të lartë, ztr. *Meha* së pari na është drejtuar me një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-3062/12) me të cilën ka kërkuar sqarim rreth funksioneve të tija publike. Në këtë shkresë ztr. *Meha* ka deklaruar se ai është anëtar i Bordit me mandat të skaduar, dhe në kohën kur janë dal konkurset e reja për at Bord ai nuk ka shfaq interesim të konkuroj sërish, sepse dëshiron që ta mbajë poziten e Kryshéfít Ekzekutiv në Agjencionin Katasteral të Kosovës.

Duke qenë se ushtrimi i njëkohësishëm i këtyre dy detyrave, konform nenit 16 paragrafi 1 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesi, paraqet situatë të papajtueshme, në takim me zyrtarin Meha kemi kërkuar që ai të përcaktohet për njëren nga këto dy funksione.

Ndërkohë në Agjencinë kundër Korrupsionit ka ardhë shkresa zyrtare (DPK/DPKI-03-100/2013) e shkruar nga ztr.Murat Meha me të cilën ai i është drejtuar Njesisë për Politika dhe monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në kuadër të MZHE-së duke ofruar dorëheqjen e tij si Anëtar i Bordit të Kompanisë Publike "Ibër –Lepenci" SH.A, për të vazhduar kontributin e tij profesional si Kryeshef në Agjencinë Katastrale të Kosovës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

